

## RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS NDERTIMI "HIDROCENTRALET ZHEJE 1&2"

Kodi 3.Ë



Ndertohet: fshatin Zheje, bashkia Mamurras, rrethi Kurbin.

AUTOR:

MSC. ERDONA DEMIRAJ

MSC. Ing. Ervin DOÇAJ



TIRANE, Tetor 2014

---

**SHKURTESAT**

---

<b>VNM</b>	Vleresim i Ndikimit ne Mjedis dhe Social
<b>Hec</b>	Hidrocentral
<b>kW</b>	KiloVat
<b>MW</b>	MegaVat
<b>kWh</b>	KiloVat ore
<b>VM</b>	Vepra e Marrjes
<b>kV</b>	KiloVolt
<b>L</b>	Gjatesia
<b>Dn</b>	Diametri
<b>ml</b>	Meter lineare
<b>Hbruto</b>	Disniveli lartesisë bruto
<b>Hneto</b>	Disniveli lartesisë neto
<b>m<sup>2</sup></b>	meter katrore
<b>m<sup>3</sup></b>	meter kub
<b>El</b>	Elevation (lartesia)
<b>ESHA</b> (vegjel)	European Small Hydro Association (Shoqata Europiane e Hec te



## Permbledhje

<b>1. SHTOJCAT DHE MATERIALET GRAFIKE .....</b>	<b>5</b>
<b>1. PERMBLEDHJE EGZEKUTIVE .....</b>	<b>6</b>
1.1 GRUPI I EKSPERTEVE .....	6
1.2 KUADRI LIGJOR.....	6
1.3 GJETJET KRYESORE .....	7
1.4 METODOLOGJIA.....	7
1.5 REKOMANDIME .....	8
1.6 MATRICA EMERTUESE .....	8
1.7 DISKUTIMET PUBLIKE .....	8
1.8 IDENTIFIKIMI I GRUPEVE TE INTERESIT .....	8
1.9 MONITORIMI DHE VLERESIMI .....	8
1.10 BUXHETI .....	8
1.11 KONKLUZIONE .....	9
<b>2 TITULLI I PROJEKTIT .....</b>	<b>9</b>
2.1 SFONDI I PROJEKTIT.....	9
2.2 QELLIMI I PROJEKTIT.....	10
2.3 VENDET DHE PROCESET ALTERNATIVE TE MARRA NE KONSIDERATE .....	10
2.4 PERSHKRIMI I ZONES .....	10
➤ FAKTE.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
➤ POZICIONI GJEOGRAFIK.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
➤ POPULLSIA NE KOMUNE .....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
➤ TOKA.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
➤ AGRIKULTURA .....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
2.5 KRAHASIMI I VARIANTEVE.....	13
2.6 KOMPONENTET E PROJEKTIT .....	16
2.7 AKSESI RRUGOR .....	20
2.8 HARTIMI I PLANIT TE REHABILITIMIT (VEND - DEPOZITIMET).....	20
2.8.1 PUNIMET NE VEND – DEPOZITIM SI SHKAK I AKTIVITETIT .....	24
2.8.2 MBYLLJA E VEND - DEPOZITIMIT.....	25
2.8.3 SISTEMIMI I MATERIALEVE NE VEND - DEPOZITIM .....	25
2.8.4 PUNIMET E SISTEMIMIT TE DHEUT .....	25
2.8.5 SISTEMIMI I COPERAVE TE SHKEMBINJVE.....	26
2.8.6 PUNIMET E MATURIMIT TE SHTRATIT TE DHEUT.....	26
2.8.7 MBJELLJA E FIDANEVE DHE BIMESISE VENDASE .....	26
2.8.8 VLERAT E PUNIMEVE ME NDIKIM NE TERREN.....	26
2.9 MASAT PER PARANDALIMIN E RREZIQEV DHE AKSIDENTEVE.....	30
2.9.1 MASAT PER PARANDALIMIN E RREZIQEV DHE AKSIDENTEVE NE PUNE .....	30
2.9.2 MASAT PER PARANDALIMIN MBROJTJEN E PYJEVE NGA ZJARRI.....	32
2.10 LINJA ELEKTRIKE DHE VLERESIMI MJEDISOR PER ZHEJE 1&2.....	34
2.10.1 PERSHKRIMI I GJENDJES SE ZONES DHE KOMPONENTEVE TE LINJES .....	34
2.10.2 NDIKIMET NË MJEDIS DHE MASAT PER PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN E TERE.....	36



<b>3. FAKTORET MONITORUES GJATE FAZES SE NDERTIMIT DHE OPERIMIT TE ZHEJE 1&amp;2</b> .....	<b>38</b>
3.1 MASAT KORRIGJUESE .....	38
3.2 FAKTORI I LINJES ELEKTRIKE .....	39
3.3 FAKTORI I AJRIT .....	39
3.4 FAKTORI I BIMESISE .....	39
3.5 FAKTORI I PEJSAZHIT .....	39
3.6 FAKTORI I FAUNES .....	40
3.7 FAKTORI I ZHURMAVE .....	40
3.8 PROGRAMIT I MONITORIMIT .....	41
<b>4. SIGURIMI I RRJEDHES MINIMALE (PRURJES EKOLOGJIKE)</b> .....	<b>41</b>
4.1 NDIKIMI NE PEJSAZH .....	44
4.2 NDIKIMI NE TOKE (PRONA) .....	45
4.3 MBETJET E NGURTA .....	45
4.4 NDIKIMI NE REGJIMIN DHE PERDORIMIN E UJERAVE .....	45
4.5 NDIKIMI NE PERBERJEN E FLORES .....	46
4.6 NDIKIMI NE PERBERJEN E FAUNES .....	47
4.7 NDIKIMI NE REGJIMIN E ZHURMAVE .....	48
4.8 NDIKIMI NE EROZION .....	49
4.9 NDIKIMI NE MJEDISIN HUMAN .....	49
4.10 NDIKIMI NE QARKULLIM DHE INFRASTRUKTURE .....	49
4.11 NDIKIMI NE HABITATET, OBJEKTET ME STATUS TE CILESUAR .....	50
4.12 NDIKIMET ME NATYRE NDERKUFITARE .....	50
4.13 NDIKIMI NE SISTEMIN E UJITJES DHE KULLIMIT .....	50
4.14 NDIKIMI NE TURIZEM .....	50
4.15 NDIKIMI NE EKONOMI .....	50
4.16 NDIKIMET E TJERA QE SHOQEROJNE PROJEKTIN .....	51
<b>5. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME</b> .....	<b>60</b>
<b>6. SHTOJCAT DHE MATERIALET GRAFIKE</b> .....	<b>61</b>

**LISTA E FIGURAVE**

- Figure 1: Harta e lokalitetit te Bashkise Mamurras  
 Figure 2: Harta e komponenteve te KASKADES Zheje 1&2 (fisibilitetit)  
 Figure 3: Harta e komponenteve te KASKADES Zheje 1&2 (faza e zbatimit)  
 Figure 4: Pamje e bimesise ne Luginen e Ploçkes, Dolit dhe Gjerushit, ku do ndertohen H/C Zheje 3, 4 & 5  
 Figura 5: Pamje korridorit te linjes ne zona me peme te larte  
 Figure 6: Paraqitje skematike e linjes elektrike  
 Figure 7: Paraqitje skematike e zgares per mbrojtjen e amfibeve dhe peshqve



#### LISTA E TABELAVE

---

- Tabela 1: *Ne variantin e fisibilitetit Zheje 1&2 kishte si karakteristika:*  
Tabela 2: *Ndersa ne variantin e zbatimit kemi:*  
Tabela 3: *Komponentet e kaskades Zheje 1&2 dhe koordinatat gjeografike UTM:*  
Tabela 4: *Vlerat e voPerreve te germimeve te kaskades Zheje 1&2:*  
Tabela 5: *Koordinatat sipas sistemit (UTM) per vend – depozitimin.*  
Tabela 6: *Vlerat e standarteve te rekomanduara nga Organizata Boterore e Shendetesise ne lidhje me fushat elektromagnetike.*  
Tabela 7: *Tipet e Mjediseve Natyrore të Peisazhit*  
Tabela 8: *Reptilet e pranishem ne zonen e studiuar*  
Tabela 9: *Amfibet e pranishem ne zonen e studiuar*  
Tabela 10: *Gjitaret e pranishem ne zonen e Zones se studiuar*  
Tabela 11: *Tabela e identifikimit te ndikimeve ne mjedis te projektit dhe ceshtjet mjedisore qe trajtohen ne projekt.*  
Tabela 12: *Tabela permbledhese e ndikimeve*  
Tabela 13: *Tabela e punimeve dhe ristrukturimi i mjedisit*

#### 1. SHTOJCAT DHE MATERIALET GRAFIKE

---

- Shtojca 1: *Harta me planvendosjen e kaskada H/C Zheje 1&2*  
Shtojca 2: *Harta me vend – depozitimet e shesheve te kaskades H/C Zheje 1&2*  
Shtojca 3: *Harta me gjurmen e linjes elektrike 10 KV*  
Shtojca 4: *Kopje e certifikates se eksperteve te mjedisit dhe studios projektuese (QKR)*



## 1. PERMBLEDHJE EGZEKUTIVE

---

Objektivi kryesor i ketij zhvillimi infrastrukturor eshte qe te adresojë disa komponente kritike te standarteve te uleta te jeteses ne zonat e projektit nepermjet ndertimit te H/C Zheje 1&2 bashkia Mamurras, rrethi Kurbin me qellim qe te siguroje nje lidhje infrastrukturore energjitike te besueshme midis zones se fshatrave te zones perreth me qendren e bashkise, gjithashtu dhe te zhvilloje kapacitetet Infrastrukturore, Ekonomike, Turistike te rajonit duke inkurajuar popullsine vendase dhe te permiresojë jetesen e banoreve ne keto zona. Hidrocentralet Zheje 1&2 shtrihen jo shume larg rrjetit rrugor te bashkise Mamurras dhe permiresimi i kesaj infrastrukture rrugore ka qene prioritet per bashkine veçanerisht pas fillimit te aktivitetit turistik ne kete zone. Ndertimi i hidrocentraleve Zheje 1&2 lidhet ngushte me infrastrukturen aktuale dhe ate qe nevojitet per ndertimin dhe funksionimin e kesaj kaskade çka rrjedhimisht rrit cilesine e infrastruktures dhe permireson ndjeshem cilesine e jeteses se ketyre banoreve qe jetojne ne keto zona.

### 1.1 Grupi i eksperteve

Grupi i eksperteve eshte angazhuar nga Instituti "Dekliada - Alb" Sh.p.k per te hartuar raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM), per te vleresuar dhe lehtesuar problematiken qe lind per shkak te ndertimit te Zheje 1&2, veçanerisht ne kend-veshtrimin mjedisor, infrastrukturor dhe ekonomik.

Se pari, ky raport kontribuon per identifikimin dhe zbutjen e ndikimeve te mundeshme te lokalizuara gjate fazes se ndertimit te Zheje 1&2.

Se dyti, siguron nje Vleresim te Ndikimeve ne aspektin Mjedisor (VNM) qe mbulon floren, faunen dhe njerezit e influencuar direkt ne percaktimin e impakteve mjedisore, sociale, ekonomike, kulturore te projektit si dhe aktivitetet jetesore te komunitetit te prekur.

### 1.2 Kuadri Ligjor

Ky raport i ndikimit ne mjedis eshte hartuar duke patur parasysh legjislacionin e shtetit shqiptar, me akte juridike ligjore dhe nenligjore specifike qe rregullojne ushtrimin e aktivitetit te investimeve dhe gjithashtu aktet ligjore lidhur me mbrojtjen e mjedisit si me poshte:

#### LIGJE

- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Mbi lejet mjedisore" (tashmë në fuqi që në janar 2013, 18 muaj pas botimit më 05.08.2011 në Fletoren Zyrtare).
- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Mbi mbrojtjen mjedisore" (tashmë në fuqi që në nëntor 2013, 18 muaj pas botimit më 30.06.2011 në Fletoren Zyrtare).
- Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor" (tashmë në fuqi që në janar 2013, 18 muaj pas botimit më 01.08.2011 në Fletoren Zyrtare).
- Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Mbi menaxhimin e mbetjeve integruara". Ky ligj parashikon klasifikimin e mbetjeve, procedurat e menaxhimit të mbetjeve përishirë monitorimin



dhe masat e kontrollit. Ai gjithashtu përshkruan kriteret që duhet të përfshihen në lejet mjedisore.

- Ligji nr.8906, date 06.06.2002 "Per zonat e mbrojtura"
- Ligji nr. 9868, date 4.02.2008 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8906, date 6.06.2002 "Per zonat e mbrojtura"
- Ligji nr.10006, date 23.10.2008 "Per mbrojtjen e faunes se eger"
- Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji nr 111/2012 Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore.

### VKM

- Vendim i KM nr. 13, datë 4.1.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis".

### Udhezimet

- Udhezim nr 3, date 02.12.2013 dok per VNM dhe Leje Mjedis.
- Udhezim nr 6, date 27.12. 2006, Per miratimin e metodologjise se Vleresimit paraprak te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

## 1.3 Gjetjet Kryesore

Raporti (VNM) eshte pregatitur mbi bazat e informacioneve te grumbulluara permes investigimit te zones (ekspeditave), intervistat gjysem te strukturuara dhe informale, si dhe permes diskutimeve me grupet e fokusuara dhe dialogjet me komunitetin apo njerezit e influencuar. Karakteristikat kryesore social – ekonomike te zonave te intervistuar jane identifikuar dhe paraqiten ne tabelen perkatese ne vijimesi te ketij raporti.

Bashkia Mamurras e perfshire ne procesin e permbushjes se detyrimeve ligjore ne dokumentacionin ligjor si dhe si zona perfituese ne menyre direkte nga ky investim do kontribuojne ne mbarevajtjen e ketij procesi duke krijuar lehtesira kohore per Kompanine Investitore.

Diskutimet e realizuara gjate vizitave ne terren kane nxjerre ne pah dijenine dhe interesimin e vendasve per kete investim duke paraqitur interes per punesim dhe ruajtje te sistemeve vadites. Duke patur parasysh standartet ekstremisht te uleta te jeteses ne keto zona, keto punesime do te sherbejne per te siguruar te ardhura shtese por te qendrueshme per nje pjese te konsiderueshme banoresh gjate fazes se ndertimit si dhe te ardhura te qendrueshme per pjesen e stafit qe do punesohen gjate gjithë kohes se operimit te Zheje 1&2, e theksojme se ky investim eshte shume i nevojshem per te gjithë zonen pasi orfron zgjidhje te problemeve te cilat asnjehere nuk jane diskutuar ne tavolina pune per zgjidhjen e tyre sic jane infrastruktura e furnizimit me energji elektrike, kanalet vadites dhe infrastruktura rrugore.

## 1.4 Metodologjia

Per te plotesuar objektivat e studimit jane perdorur qasje sistematike te integruara dhe perfshirese. Jane perdorur instrumentat e meposhtem:



- Investigim ne terren
- Hartat e zones (Rrjeti i zonave te mbrojtura, topografike, gjeologjike dhe hidrogjeologjike)
- Intervista me banore te zones
- Disa prej njerezve te konsultuar jane persona te prekur nga projekti ne ndertimin e infrastruktures se zones e cila do sherbeje ne ndertimin e nenveprave te Zheje 1&2.

### 1.5 Rekomandime

Gjate ndertimit te Zheje 1&2, pjese e supervisionit te H/C – ve duhet bere edhe monitorimi nga eksperte mjedisore per realizimin e monitorimeve dhe vleresimeve mjedisore i cili eshte i nevojshme per te garantuar cilesine e punimeve ne lidhje me mjedisin ku shtrihen nenobjektet e kesaj kaskade, gjithashtu per te mbajtur nen kontroll elementet mjedisore gjate fazes se ndertimit, kriter ky sipas kushteve te lejes mjedisore.

Investitori duhet te kete parasysh se: gjate realizimit te ndertimeve me qellim punesimi i banoreve vendas do te luaje nje rol pozitiv ne minimizimin e gjendjes social – ekonomike te tyre.

### 1.6 Matrica Emertuese

Bazuar ne kornizen e adaptuar te politikes, nje matrice permbledhese emertuese eshte pregatitur duke reflektuar gjithë kategorite e banoreve te prekur dhe te gjitha llojet e humbjeve qe shoqerojne cdo kategori.

### 1.7 Diskutimet Publike

Diskutime jane bere me grupe individesh te zones ku ndikimi i projektit dhe kompensimet e propozuar si dhe masat lehtesuese u jane shpjeguar dhe diskutuar.

### 1.8 Identifikimi i grupeve te interesit

Nje seri mbledhjesh me grupet e fokusuara, intervista informale dhe seminare jane mbajtur me grupet e interesit ne te gjithë zonat prane te projektit dhe masat lehtesuese u jane shpjeguar te pranishmeve permes diskutimeve.

### 1.9 Monitorimi dhe Vleresimi

Investitori do te koordinoje te gjitha aktivitetet monitoruese. Monitorimi i brendshem do te behet nga Eksperti i mjedisit i cili eshte njohur me procesin e hartimit te projektit te zbatimit mbi te cilin eshte hartuar ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per te siguruar qe zbatimi i projektit dhe masat zbutese jane ndjekur me rigorozitet.

### 1.10 Buxheti

Siç u permend me lart, investitori ka kontaktuar konsulente te specializuar per hartimin e projektit te zbatimit mbi te cilin hartohen dhe preventivat perkates. Si rezultat, ne faza pergatitore ze nje kosto e cila mbulohet nga investitori gjithashtu edhe faza ndertimore.





## 1.11 Konkluzione

Zhvillimi i propozuar eshte nje investim kyc ne kete zone, perfitimet e se ciles zgjerohen ne aspekte te ndryshme te komunitetit te prekur direkt si dhe per te tjeret te prekur indirekt.

Së pari dhe më kryesorja, kjo do të sigurojë një lidhje të besueshme infrastrukturore ndermjet bashkise Mamurras dhe fshatrave te zones të cilat janë përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij projekti.

Megjithatë, ky investim është domethenes për një rajon më të gjerë te komunes dhe fshatrave të cilat e bëjnë me te qendrueshem kete investim për shkak të lidhjeve të forta kulturore dhe ekonomike. Duke pasur parasysh zhvillimet e fundit turistike në rajon, të tilla si ajo në fshatin Zheje, ky investim është një komponent i rëndësishëm për industrinë e turizmit. Shume turistë tashmë kane frekuentuar gjatë verës keto zona ku permiresimi i infrastruktures energjitike, rrugore do të mundësojë së paku pjesërisht në ngritjen e kapaciteteve që do të tërheqë më shumë vizitorë per kete rajon, çka per rrjedhoje do të kthehet në permiresim ekonomik per ta.

Me zbatimin e masave lehtësuese, sikurse eshte dhe ky raport VNM, ndikimi i pergjithshem mjedisor i projektit do te minimizohet.

## 2 Titulli i Projektit

*"Hartimi i raportit te Ndikimit ne Mjedis, Faza e zbatimit" Ndertimi i Zheje 1&2, bashkia Mamurras, rrethi Kurbin.*

### 2.1 Sfondi i Projektit

Pasurite e medha ne burime ujore dhe peizazhi i mrekullueshem i Shqiperise, shoqeruar me kushtet klimaterike, hidrografike, dhe gjeomorfologjike te pershtatshme per krijimin e rrjedhjeve natyrore me prurje dhe renie te medha, bejne te mundur shfrytezimin hidroenergjitik me interes te konsiderueshem ekonomik. Shqiperia renditet ne Evrope si nje vend me pasuri ujore te konsiderueshme, me nje shtrirje hidrografike te shperndare pothuaj ne te gjithë territorin. Me sipërfaqen e saj prej 28 748 km<sup>2</sup>, ne pergjithesi eshte nje vend malor, ku 70% te saj e zene malet, kodrat, liqenet dhe sipërfaqet e shtreterve te Perrenjve.

Territori hidrografik i Shqiperise ka nje sipërfaqe ujembledhese prej rreth 44 000 km<sup>2</sup>, ose 57% me shume se territori shtetëror. Ne territorin hidrografik te Shqiperise bien mesatarisht rreth 1400mm shi ne vit. Ne lartesine mbi 1000m bien rreshje bore, ku ne zonat e thella malore ajo qendron per disa muaj, duke siguruar ne kete menyre furnizimin me uje te Perrenjve e te degeve te tyre per periudhen e pranveres e deri diku edhe te veres.

Nga pikpamja topografike, duke qene nje vend me relief relativisht te thyer, vendi yne ka nje rezerve hidroenergjitike te madhe. Perfitimi me i madh nga shfrytezimi i energjise ujore, realizohet nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te medhenj, por ineteres paraqet edhe shfrytezimi i energjise ujore nepermjet hidrocentraleve te vegjel dhe te mesem.

Kohet e fundit eshte rritur edhe iniciativa per ndertimin e hidrocentraleve te vegjel duke gjetur edhe mbeshtetjen e qeverise, e cila me legjislacionin e saj lehteson veshtiresite burokratike duke bere te mundur koncesionimin e tyre brenda nje kohe mjaft te shkurter.



Kompleksi hidroenergjitik Zheje kap nje fuqi te instaluar afro 0.678 MW çka si potencial kryesor te fuqise se instaluar ka renien e ujit nga lartesia e konsiderueshme si dhe sasine e ujit me baze burimesh dhe kontribute reshjesh nga perroi i Pllloçkes, Dolit dhe Gjerushit.

## 2.2 Qellimi i Projektit

Qellimi i ketij studimi eshte te shfrytetoje potencialin uJOR te perroit te Pllloçkes, Shiut dhe Gjerushit dhe degeve te tij per gjenerimin e energjise elektrike, bazuar ne prioritetin e Qeverise Shqiptare mbi zhvillimin e sektorit energjitik prodhues.

Studimi dhe projektimi mbi mundesine e perdorimit te ujit per qellime gjenerimi te energjise elektrike bazohet ne renien e lire te ujit. Kjo energji klasifikohet si energji e paster me veti zero te clirimit te gazrave karbonik dhe mund te perfshihet brenda politikave ambjentale dhe ekonomike te krediteve te karbonit si aktivitet gjenerues I paster, politike kjo mjaft e kerkuar nga vendet e industrializuara.

Mbeshtetur ne studimet perkatese hidrografike, gjeologjike dhe topografike te rajonit, te kryera enkas per kete qellim, si dhe te rikonicionit te shpeshte ne vend per te saktuar akset e marrjes se ujit, Linjat e derivacionit, vendosjen e godines se centralit, etj, pa harruar dhe matjet hidrometrike dhe topografike ne vend u arrit ne perfundimin qe **Kaskada Zheje 1&2 do te kete nje fuqi te instaluar perkatesisht  $242+436=678\text{kW}$ .**

## 2.3 Vendet dhe proceset alternative te marra ne konsiderate

Si vende te ngjashme te marra ne konsiderate jane Hec – Smokthine ne Vlore, Hec – Gjancit ne Korce, Hec – i Bogoves (Skrapare), Curraj (Tropoje) etj ku ish sistemet vaditese qe sherbenin per bujqesine ne periudha te caktuara gjate vitit perdoren per prodhimin e energjise elektrike por pa nderprere apo prishur regjimin uJOR te aktivitetin ekzistues. Ose nder Hec – et e reja qe priten te inagurohen dhe qe po shfrytëzohen ne perputhje me kete iniciative te qeverise mund te permendim: Hec Cernaleve, Lapaj, Kompleksi i hec – eve Lure dhe Hec Kryezi 1 dhe Hec Kryezi 2 etj.

## 2.4 Pershkrimi i zones

### Pozicioni -gjeografik i objektit

Sipas klasifikimit klimatik te vendit tone, zona qe po studiojme hyn ne Ultesiren bregdetare qendrore (kodrat ne mes te Lezhes dhe Tiranes).

Pellgu ujembledhes i perroit te Zhejit nga veriu kufizohet nga qendra e banuar e Gjormit, kodrat e Skungjellit (420m m.n.d), kodrat e Selites (Kuqni) (383 m m.n.d) deri tek maja malit Kurrizi Baulit (792 m m.n.d).

Ne lindje nga mali Kurrizi Baulit me kuote (805 m m.n.d), maja e Pocit (938 m m.n.d) dhe perfundon tek mali i Kurtellit (1030 m m.n.d).

Ne jug kufizohet me Perroin e Drojes, malin Buzes Gurthit (762 m m.n.d) me fshatin Shemri dhe vija ujendarese zbret deri ne kuoten (266 m m.n.d).



Ne perendim kufizohet me Kodren e Madhe (258 m m.n.d), me fshatin Zhej ku eshte ndertuar dhe rezervuari i Zhejit per vaditje dhe me perroin e Shiut.

Konfiguracioni orografik i zones ne studim paraqitet me relief kodrinor ne zonen perendimore me nje amplitude qe fillon nga kuotat 250-800 m m.n.d ne zonen perendimore te pellgut ujembledhes te perroit te Zhejit. Konfiguracioni orografik kushtezon regjimin e reshjeve lidhur me faktin qe ne te gjithe zonen qe i eshte ekspozuar detit Adriatik, kurrizi i Baulit me kuote (800-900 m m.n.d) ushtron nje veprim te tille qe "kapin" rrymat ajrore me lageshti dhe per rrjedhoje kjo zone malore e brendshme merr reshje shiu te bollshme ndersa zonat e rrafsheta bregdetare ne pergjithesi kane pak reshje. Kurrizet kodrinore te zones ne studim qe perbejne pellgun ujembledhes te perroit te Zhejit perfaqesojne rrudha antiklinare te gjata me shpate te buta asimetrike.

Zona kodrinore dallohet per relievin e valezuar dhe i copetuar nga vija, prroska dhe perrenj, shumica me rrjedhje ujore te perkoeshme.

Nga ana litologjike formacionet baze ne basenin ujembledhes te perroit te Zhejit jane argjila alevrolite, ranore-flishe me ujera nentokesore mesatare dhe te pakta dhe argjila ranore gelqerore (flishe).



Ne pergjithesi tokat jane stabile dhe relativisht te stabilizuara, mesatarisht te pershkushme dhe lehtesisht te gerryeshme. Tokat jane livadhore te hirta kafe.

Bimesia eshte e perfaqesuar nga shkurret mesdhetare ne kete zone dhe shtrihet deri ne kuoten (400-500 m m.n.d). Perbehet nga makja gjethembajtese.

Figure 1: Harta e lokalitetit te Bashkise Mamurras



Koordinatat gjeografike te bashkise Mamurras jane:

Sistemet koordinative	Easting	Northing
WGS84	19° 41' 30"	41° 34' 51"
Spherical Mecator (Google)	2192072.94	5098389.84
UTM Zone 34N	390942.52	4604060.41
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4391029.54	4606034.23

#### NDËRTIMI GJEOLOGJIK. Vecorite morfologjike dhe morfogjenetike.

Nga pikpamja *geomorfologjike* zona e studimit i perket zones malore dhe kodrinore qe shtrihet ne veri te Perroit te Drojes. Nga pikepamja tektonike zona ne fjale perfshihet ne zonen tektonike "Kruja", nenzona e "Dajtit".

Depozitimet me te vjetra qe zbulohen ne sipërfaqe ne zonen "Kruja" jane depozitimet karbonatike te Kretakut. Keto depozitime kane ndryshime te theksuara faciale.

Ne zonen Kruja depozitimet karbonatike pergjithesisht i takojne Kretakut te siperme Cr2.

**KLIMA** Zona ne studim shtrihet ne nenzonen klimatike mesdhetare kodrinore qendrore, sipas klasifikimit klimatik te vendit tone.

Temperatura mesatare vjetore te ajrit lëkundet nga 11-13°C, ne pjeset e uleta te pellgut ujembledhes arrin deri ne 15 °C. Temperatura mesatare e janarit qendron ne kufirin 4-6 °C. Minimumet absolute te temperatures zakonisht ulen nga -8°C deri -7 °C dhe ne dimra te ftohte shkon nga -13 °C deri ne -12°C. Ne raste te jashtezakonshem e ne kushte te pershtatshme terreni mund te vrojtohen temperatura te uleta nga -17 °C deri -15°C. Dite te akullta vrojtohen 20-30 dite ne vit. Persa i perket temperatures mesatare te muajit me te ngrohite nenzona dallohet per temperatura mesatare te larta qe ne disa pika arrin kufirin 24-25 °C. Ne shperndarjen e reshjeve verehet nje uniformitet i kenaqshem. Sasia vjetore lekundet 1100-1300mm dhe ne disa vende ekstreme ajo mund te arrije deri 1600mm. Stina e dimrit ne krahasim me ate te vjeshtes mbizoteron ne te gjitha pikat.

Per shkak te ekspozicionit te pergjithshem perendimore qe ka nenzona dhe te lartesis jo shume te madhe mbi det, reshjet jane ne pergjithesi ne forme shiu. Ato ne forme bore perbejne 5- 10% te te gjithë rasteve me reshje.

Akoma me e ulet eshte perqindja e diteve me shtrese debore. Ne pjesen me te madhe te nenzones (lartesi 300-500m) ato nuk jane me shume se 7-10 dite ne vit, ndersa ne lartesite me te medha arrijne 13-17 dite. Periudha me shtrese debore vrojtohet pergjithesisht ne janar dhe shkurt ndersa per muajt e tjere eshte e rralle.

Lartesia mesatare maksimale e bores arrin deri 10cm. Lartesia maksimale e bores nje here ne 50 vjet (2% siguri) eshte 42cm, nje here ne 30 vjet (3% siguri) eshte 38cm, nje here ne 20 vjet (5% siguri) eshte 34cm dhe nje here ne 10 vjet (10% siguri) eshte 26cm.



Sipas perpunimit statistikor te elemetit meteorologjik ere, rezulton se ererat ne zonen qe eshte ne studim jane: nje here ne

50 vjet kane shpejtesine 35-40m/sek, nje here ne 20 vjet 31- 35m/sek, nje here ne 10 vjet 28-30m/sek dhe nje here ne 5 vjet 24- 27m/sek.

Zgjatja faktike e diellzimit (ore) ne vendmatjen meteorologjike Mamurras eshte 2480 ore ne vit ndersa numri mesatar i diteve me diell eshte 332 dite ne vit.

Nje analize te hollesishme te kushteve klimatike te zones ne studim tregohet ne tabelen dhe grafikun mbi shperndarjen e temperatures dhe reshjeve. Te dhenat nga vendmatjet meteorologjike Milot, Lac, Mamurras dhe Kruje respektivisht kane keto kuota : 40m m.n.d, 25 m m.n.d, 35 m m.n.d, 560 m m.n.d.

Per shkak te diferencave ne relief i cili eshte nga 250-900 m

m.n.d dhe distancen nga deti, reshjet ne kete pellg ndryshojne nga pjesa perendimore duke shkuar ne lindje ne zonen malore.

Ne krahasim me vleren mesatare ne territorin Shqiptar (1400mm), kjo zone renditet me reshje mesatare.

Siç tregohet ne grafikun e meposhtem shpërndarja e reshjeve ka një forme “U” qe është tipike e një regjimi mesdhetar te reshjeve. Sasia me e madhe e reshjeve pritet gjate periudhës se ftohte te vitit dhe muajt me te laget janë nëntori dhe dhjetori. Miloti (189mm), Laci (177mm), Mamurrasi (159mm) dhe Kruja (223mm).

Duke patur parasysh sasinë maksimale te reshjeve 24 orëshe dhe intensitetin për intervale te ndryshme kohe ne periudha te ndryshme perseritje, zona ne studim karakterizohet nga një intensitet mesatar i reshjeve (shiko grafikun).

Ne Milot sasia 24 oreshe nuk i kalon 156mm, ne Lac 140mm, ne Mamurras 106mm dhe ne Kruje 185mm.

## 2.5 Krahasimi i Varianteve

### Varianti i Fisibilitetit

Tabela 1: Ne variantin e fisibilitetit Zheje 1&2 kishte si karakteristika:

Permbledhja e te dhenave faza e fizibilitetit	Zheje 2 – 280 KW
Lartesia ku merret uji:	+207.77/207/200.8mnd
Sasia e ujit te instaluar:	$Q_{llog} = 0.326m^3/s$
Kuota e daljes se ujit nga procesi prodhues:	+ 53 mnd
Fuqia e vendosur	N= 250 kW

Permbledhja e te dhenave faza e fizibilitetit	Zheje 1 – 250 KW
Lartesia ku merret uji:	+97 mnd
Sasia e ujit te instaluar:	$Q_{llog} = 0.6m^3/s$
Kuota e daljes se ujit nga procesi prodhues:	+ 53 mnd
Fuqia e vendosur	N= 250 kW






Figure 2: Harta e komponenteve te KASKADES Zheje 1&2 (fisibilitetit)

**Varianti i zbatimit**

Tabela 2: Ndersa ne variantin e zbatimit kemi:

Permbledhja e te dhenave faza e zbatimit	Zheje 2 – 436 KW
Lartesia ku merret uji:	+207.77/207/200.8mnd
Sasia e ujit te instaluar:	$Q_{log} = 0.575m^3/s$
Kuota e daljes se ujit nga procesi prodhues:	+ 105.58 mnd
Fuqia e vendosur	



Permbledhja e te dhenave faza e zbatimit	Zheje 1 – 242 KW
Lartesia ku merret uji:	+102 mnd
Sasia e ujit te instaluar:	$Q_{log} = 0.75m^3/s$
Kuota e daljes se ujit nga procesi prodhues:	+ 58 mnd
Fuqia e vendosur	N= 242 kW




Figure 3: Harta e komponenteve te KASKADES Zheje 1&2 (faza e zbatimit)

Sqarojme se gjate hartimit te Projekt Zbatimit, investitorit i lejohet qe te beje rikompozim te veprave, gjithmone brenda kuotes se siperme dhe te poshtme te projektit, duke respektuar Dokumentat Standarte te Tenderit, megjithate ne kete projekt nuk jane bere ndryshime thelbesore dhe i gjithë projekti i zbatimit i eshte permbajtur skemes se shfrytezimit te paraqitur ne fazen e fizibilitetit. Per te qene me te qarte:

	Zbatim	Fizibilitet
Fuqia e e instaluar	678kW	530kW
Prodhimi mesatar vjetor	2'597'999kWh.	1'844'664 kWh



Siç shihet nuk ka ndryshim te theksuar si ne fuqi ashtu dhe ne prodhimin mesatar vjetor, por nje permiresim i lehte i ketyre dy treguesve.

## 2.6 Komponentet e Projektit

Tabela 3: Komponentet e KASKADES Zheje 1&2 dhe koordinatat gjeografike UTM:

HEC.ZHEJA 2			HEC.ZHEJA 1		
KOORDINATAT (SISTEMI UTM)			KOORDINATAT (SISTEMI UTM)		
	East	North	East	North	
VM 1	394749	4607438	VM (diga)	394275	4604033
VM 2	395257	4605887	Baseni 1	393990	4604090
VM 3	395878	4604730	Godina 1	393537	4604521
Baseni 2	395205	4604851			
Godina 2	395024	4604296			

## PUNIME CIVILE




Figure 4:  
Pamje e rezervuarit te Zhejes,





## Hec.Zheje 1



**Vepra e marrjes** do te ndertohet me strukture betonarme, ne perroin e Plloçkes, Dolit dhe Gjerushit ne kuoten 925 m mnd. Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese, çpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli.

### Sifoni

Tubacioni i presionit do te jete i pajisur me elektrosaracineske dhe saracineske by-pass. Eshte parashikuar pastrimi i vendit nga barishtet apo objekte te tjera, gjate gjithe gjatesise te tubacionit deri ne hyrje te centralit si edhe instalimi i kablllove te fuqise dhe te kontrollit qe lidhin basenin me ndertesën e centralit.

Parametrat kryesore jane:

- |                              |                |
|------------------------------|----------------|
| - gjatesi mesatare           | 165 ml,        |
| - sasia e ujit               | 750 litra/sek, |
| - diametri dhe lloji i tubit | Φ615mm / çelik |
|                              |                |
| - gjatesi mesatare           | 350 ml,        |
| - sasia e ujit               | 750 litra/sek, |
| - diametri dhe lloji i tubit | Φ800mm / çelik |

### Baseni i presionit

Baseni i presionit do te sherbej per ekuilibrin hidrodinamik dhe nivelin e ujit ne turbine. Baseni do te ndertohet ne aksin e tubacionit te presionit ne nivelin El.+99m mnd. Baseni do te kete dy dalje: nje per furnizimin e centralit he nje per shkarkimin e basenit. Ne basen do te instalohen paisjet per matjen e nivelit te ujit, dhe te matjeve te prurjeve ne tubacion. Pajisja per mbylljen automatike ne rast avarie (droseli) do te instalohet ne hyrje te HEC.

Njekoheresisht jane parashikuar perforcime ne pjesen bashkuese te basenit me tubacionin e presionit.




### Tubacioni i presionit

Tubacioni i presionit do te jete i pajisur me elektrosaracineske dhe saracineske by-pass. Eshte parashikuar pastrimi i vendit nga barishtet apo objekte te tjera, gjate gjithë gjatesise te tubacionit deri ne hyrje te centralit si edhe instalimi i kabllove te fuqise dhe te kontrollit qe lidhin basenin me ndertesën e centralit.

Parametrat kryesore jane:

- gjatesi mesatare 258 ml,
- sasia e ujit 750 litra/sek,
- humbja e lartesisë deri ne godine 41m.
- diametri dhe lloji i tubit  $\Phi 8000\text{mm}$  / çelik

### Hec.Zheje 2



### Veprat e marrjes

Veprat e marrjes do te ndertohen me strukture betonarme, ne kuotat 207.77, 207, 200.9 dhe 200.8 m mnd.

Punimet civile parashikojne germime, betonime perforcuese, cpime dhe sistemimi me breza ne gure te armuar dhe rrjeta teli.

### Linja e derivacionit

Linja Dekantues nr.1-Basen Presioni 1 (tipi: tubacion derivacioni)

- gjatesi mesatare 2425ml,
- sasia e ujit 215 litra/sek,
- pjerresia e tubacionit te derivacionit 2‰
- diametri i tubacionit 500mm

Linja Dekantues nr.2-Basen Presioni (tipi: tubacion derivacioni)

- gjatesi mesatare 1232ml,
- sasia e ujit 415 litra/sek,



- pjerresia e tubacionit te derivacionit 2‰
- diametri i tubacionit 700mm

Linja Dekantues nr.2-Basen Presioni (tipi: tubacion derivacioni)

- gjatesi mesatare 735ml,
- sasia e ujit 160 litra/sek,
- pjerresia e tubacionit te derivacionit 2‰
- diametri i tubacionit 400mm

### Baseni i presionit

Jane 2 vepra te tilla dhe do te ndertohen ne nivelin El.197m mnd. Secili nga basenet e presionit do te sherbej per ekuilibrin hidrodinamik dhe nivelin e ujit ne turbine. Baseni do te kete dy dalje: nje per furnizimin e centralit he nje per shkarkimin e basenit.

Ne basen do te instalohen paisjet per matjen e nivelit te ujit, dhe te matjeve te prurjeve ne tubacion. Pajisja per mbylljen automatike ne rast avarie (droseli) do te instalohet ne hyrje te HEC. Njekohesisht jane parashikuar perforcime ne pjesen bashkuese te basenit me tubacionin e presionit.

### Tubacioni i presionit

Tubacioni i presionit do te jete i pajisur me elektrosaracineske dhe saracineske by-pass. Eshte parashikuar pastrimi i vendit nga barishtet apo objekte te tjera, gjate gjithë gjatesise te tubacionit deri ne hyrje te centralit si edhe instalimi i kablllove te fuqise dhe te kontrollit qe lidhin basenin me ndertesën e centralit.

Parametrat kryesore jane:

Baseni nr.1-Godine Centrali

- gjatesi mesatare 605 ml,
- sasia e ujit 575 litra/sek,
- humbja e lartesisë deri ne godine 91.42m.
- diametri dhe lloji i tubit Ø600mm / çelik

**Ndertesat e hidrocentraleve.** Secila do te jete me nje kat, me strukture betonarme, me mure tulle, te suvatuar ne te dy anet, me solete betonarme te hidroizoluara dhe me dritare metalike me hapesire drite 40-50%. Ndertesat do te permbaj keto ambiente kryesore:

a) Sallen e agregateve ne te cilen do te instalohet grupet turbine-gjenerator, panelet e mbrojtjes, te eksitimit, te kontrollit, te rregullatoreve te shpejtesise, te nevojave vetjake elektrike dhe mekanike, te kompresorit te ajrit dhe impiantet hidraulike me presion te rregullatorit te ajrit dhe te vajit, vinci 5/10ton, etj.

b) Sallen e elektrike ne te cilen do te instalohen panelet e matjeve, te mbrojtjes te linjes 10kV, transformatori i fuqise dhe transformatori vetjak, te celave 10kV (celsat, thikat, shkarkuesa), etj.

c) Ambientin e sherbimit dhe te administrates ne te cilen do te jene instaluar paisjet e kontrollit te HEC, zyra administrative dhe dhoma e sherbimeve dhe riparimeve teknike.

Nga ana tjeter, jane parashikuar punime civile qe lidhen me montimin e paisjeve te reja, zhvendosjen ose pershtatjen e bazamenteve prej betoni, etj.

Punimet kryesore do te jene:



- Instalimi i nje sistemi te ri te ajrosjes dhe te qarkullimit te ajrit ne brendesi te centralit, instalimi i ventilatoreve qarkullues te ajrit ne sallën elektrike, ne zbarat e daljes etj.
  - Instalimi i sistemit te kullimit dhe drenazhimit per mbrojtjen e salles te makinave nga lageshtira dhe infiltrimit te ujit.
  - Instalimi i rrjetit te ndricimit, te dritareve te ajrosjes dhe te dyerve.
  - Ndertimi i aneve te mbeshtetjes te vincit (paragos) ne sallën e agregatit.
  - Instalimi i saracineskave, largimi dhe filtrimi i ujrave, etj.
  - Ndertimi i kanaleve te kablllove ne sallën e aggregateve, shtrimi me pllaka te reja, suvatimi dhe lysterja. Kryerja e punimeve te domosdoshme dhe modifikuese per montimin e makinerive dhe paisjeve te reja.
  - Ndertimi i kanaleve te kablllove te zbarave dhe te daljeve te gjeneratoreve, shtrimi me pllaka te reja, suvatimi dhe lysterja. Kryerja e punimeve te domosdoshme dhe modifikuese per montimin e makinerive dhe paisjeve te reja.
  - Ndertimi i dhomes te riparimit (oficines), shtrimi me pllaka te reja, suvatimi dhe lysterja. Kryerja e punimeve te domosdoshme dhe modifikuese per montimin e makinerive dhe paisjeve te reja.
- Kanali i shkarkimit do te kete nje gjatesi rreth 10m dhe shkarkon ne shtratin e Perroit te Madh ku Perroi i Plloçkes, Dolit dhe Gjerushit eshte dege ushqyese e Peroit te Madh.

## 2.7 Aksesi rrugor

### "Infrastruktura e zones ku ndertohet KASKADA Zheje 1&2"

Kjo zone ne pjesen e sipërme te saj nuk ka akses rrugor dhe ska patur ndonjehere rruge lidhese, kjo do te mundesohet me akses rrugor si me poshte gjate fazes se zbatimit e cila do te sherbeje edhe gjate fazes se shfrytezimit te kaskades per monitorimin e nenobjekteve.

Si element kryesor ne krijimin e aksesit infrastrukturor rrugor sherben hapja e trasese se linjave te derivacionit te cilat njekohesisht do te sherbejne edhe si rruge sherbimi gjate ndertimit dhe shfrytezimit te kaskades Zheje 1&2.

1. Aksesi rrugor per t'u futur ne pjesen e sipërme dhe te mesme te lugines se Plloçkes, Dolit dhe Gjerushit dhe ne zone do te sherbeje per futjen e makinerive te nevojshme per realizimin e punimeve te ndryshme te nevojshme per kaskades Zheje 1&2 si pjese e ketij kompleksi ne rrjedhen e sipërme te lugines se Plloçkes, Dolit dhe Gjerushit.
2. Krijon lehtësi ne levizjen e banoreve te zones.
3. Jep ndikim ne aktivizimin e turizmit ne kete zone.

Duke qene se infrastruktura ekzistuese rrugore eshte e zhvilluar prane zones se projektit, **nuk lind nevoja e hapjeve te rrugeve te reja te kantierit.**

## 2.8 Hartimi i planit te rehabilitimit (Vend - depozitimet).

Plani i rehabilitimit perfshin zonat ku do realizohen punime rehabilituese, voPerroit dhe lloja e punimeve, perfshire edhe afatet kohore te realizimit te punimeve te rehabilitimit dhe koston sipas zerave.

**Projekti ne fjale ka vlera te medha inxhinierike dhe perfitime te konsiderueshme ekonomike**  
Per kete aktivitet qe ne po shqyrtojme kemi te bejme me nje hidrocentral i cili do te sherbeje si nje



garanci energjitike per zonen ne periudhen e lagesht ne sasi dhe cilesi. Per kete eshte e nevojshme qe te kete bashkepunim me autoritetet vendore dhe grupet e interesit, per ruajtjen e parametrave hidroenergjitike pa prishur ekuilibrat mjedisore dhe ato te nevojave te popullates per nevoja te ndryshme.

Projekti ka nevoje per monitorim mjedisor rigoroz gjate fazes se ndertimit nga organet kompetente si dhe nje kujdes paresor duhet te realizohet nga investitori dhe popullata vendase te luaje rol aktiv per gjerat qe e shqetesojne lidhur me investimin ne zonene tyre.

Pas ndertimit te nenveprave duhet te mbahet nen mbikqyrje rehabilitimi i zonave te prekura nga punimet i cili duhet te filloje menjehere mbas perfundimit te punimeve perkatese per cdo nenobjekt te kaskades.

Ndertimi i Hec-ve Zheje 3,4 & 5 gjeneron nje voPerr materialesh te germuara ne masen 9'929 m<sup>3</sup>, nga te cilat rreth 3'314 m<sup>3</sup> jane mbushje dhe do te perdoren per mbulimin e objekteve mbas perfundimit te punimeve. Te 'gjitha dherat ne masen 6'615 m<sup>3</sup>, te cilat gjenerohen nga germimet e ndryshme do te sistemohen ne sheshin e percaktuar dhe paraqitur ne harten bashkelidhur, kurse pjesa tjeter e voPerrit te germimeve do te perdoren per rehabilitime te rrugeve rurale pyjore, te cilat do te shfrytezohen per ndertimin e nenobjekteve te hidrocentraleve Zheje 1 dhe Zheje 2.

**Zheje 1**

<b>Germim</b>	<b>3,955</b>
<b>Mbushje</b>	<b>1,295</b>
<b>Skarifikim</b>	<b>1,000</b>
<b>Vend-depozitim</b>	<b>2,660</b>

**Zheje 2**

<b>Germim</b>	<b>5,974</b>
<b>Mbushje</b>	<b>2,019</b>
<b>Skarifikim</b>	<b>1,880</b>
<b>Vend-depozitim</b>	<b>3,955</b>




Me poshte paraqiten masat rehabilituese per kaskaden kaskades Zheje 1&2 si pjese e planit rehabilitues.

➤ **(Vend-depozitimet)**


Koordinatat sipas sistemit (UTM) per vend – depozitimin.

Hec-et Zheje	Pikat topografike	X	Y
Venddepozitimi nr.2	Pika 1	393672.73	4604184.99
	Pika 2	393744.94	4604178.93
	Pika 3	393719.04	4604142.26
	Pika 4	393659.51	4604156.67



Hec-et Zheje	Pikat topografike	X	Y
Venddepozitimi nr.1	Pika 1	395029.71	4604329.79
	Pika 2	395066.58	4604344.41
	Pika 3	42 15 32.33	4604313.17
	Pika 4	395039.09	4604299.08





### 8.1.2 TE DHENAT E SHESHIT TE VENDDEPOZITIMIT

Siperfaqia

- 1) Objekti 1  $S=810 \text{ m}^2$
- 2) Objekti 2  $S=4'700 \text{ m}^2$

Kapaciteti Ditor i Depozitimit:  $30-50 \text{ m}^3 / \text{dite}$ .

Sic e kemi shprehur edhe ne komponentin e centraleve "Linjat e derivacioneve" hapja e ketyre linjave gjeneron mase materialesh te cilat mendohet te jene te larta. Mirepo gjithashtu duke iu referuar sqarimit ne kete komponent kemi te bejme me nje mase materiali e cila sistemohet karshi vendit te germuar duke krijuar sheshin e trasese se linjes dhe rruges se sherbimit.

Planifikimi i ketij vend depozitimi eshte bere ne pershtatshmeri me terrenin duke e projektuar ate ne sinkron me relievin duke shfrytezuar hapesirat boshe te tij, ne hapesira jo te pyllezuara duke mos patur ndonje ndikim ne mjediset perreth.

Gjithashtu jane marre parasysh edhe formacionet e materialeve qe do te germohen dhe qe do te depozitohen ne projektimin e ketij vend-depozitimi, ne menyre qe te mos shfaqin probleme ne stabilitetin e tyre ne vetvete, duke evituar ndonje rreshqitje te dherave te ketij venddepozitimi.

Nje pjese e materialit te germuar do jete e destinuar per t'u perdorur per rehabilitimin e shesheve te germuara, krijimin/permiresimin e traseve te ndryshme te rrugeve.

Materiali qe do te depozitohet eshte kryesisht material me perberje shkembore, aluvione te cimentuara, si dhe materialet me perberje dherash te cilat do te depozitohen me vete dhe do te perdoren si mbulesa e ketij venddepozitimi ne menyre qe me kalimin e kohes vegetacioni ne keto zona mund te zhvillohet.

Gjithashtu i gjithe materiali qe do te depozitohet do ngjishet, dhe nqs eshte e nevojshme do te krijohen te gjitha kanalet drenazhuese perreth venddepozitimit ne menyre qe t'ajerat siperfaqesore te mos pengohen nga rrjedhja e tyre.



Projektimi i ketij venddepozitimi eshte bere ne menyre te tille ku jane evituar te gjitha konfliktet me objektet qe ndodhen ne kete zone, duke iu shmangur edhe zonave te banuara ne menyre qe te eleminohen edhe risqet me te vogla nga prania e ketij venddepozitimi.

Si e kemi permendur me lart siguria ne stabilitet e ketij venddepozitimi eshte studiuar duke pasur parasysh formacionin gjeologjik te materialeve, ku mbi bazen e ketyre parametrave jane pershtatur edhe pjerresite e skarpatave te ketij venddepozitimi te cilat variojne nga 0 ne 4 m trashesi depozitimi.

Gjithashtu per te ruajtur keto depozitime nga erozioni apo shkarjet do te behet nje ngjeshje e mire e saj per te shmangur fundosje te ketyre shtresave te tokes. Per te zvogeluar efektin e shpellarjeve te ketyre siperfaqeve nga rreshjet e shiut pjerresite e nevojshme me kanalet e hapura do te formohen ne siperfaqet e ketij venddepozitimi.


Megjithese nuk paraqitet e nevojshme, por nqs do te jete e tille ne fund skarpatat e ketij venddepozitimi mund te ndertohen ca mure mbajtese lokale me ane te materialit shkembor (Gure te Medhenj) ne menyre qe te evitohen rreshqitjet.

### 2.8.1 Punimet ne vend – depozitim si shkak i aktivitetit

Punimet e per ndertimin e vend-depozitimit konsistojne ne punime hapje dhe sistemimi te sheshit per qellimin qe do te kryejne.

Ne sheshin e vend-depozitimit nuk eshte e nevojshme ndertimi i ambjenteve ndihmese. Punimet e ndertimit do te konsistojne ne:

- Heqjen e kores se tokes
- Ndertimi i kanaleve per mbledhjen e ujrave te shiut
- Rrethimi i siperfaqes se vend-depozitimit me mur teli
- Procesi i transportit te materialeve dhe sistemimi i tyre



Ne projektin per ndertimin e hidrocentraleve Zheje 1&2 bejne pjese struktura te ndryshme inxhinierike, per ndertimin e te cilave kryhen punime hapje dhe germimi.

Hapja e tubacionit eshte nje nder veprat ku sasia e dheut ku gjenerohet eshte me e konsiderueshme, per pasoje ndertimi i sheshit per depozitimin te materialeve eshte nje domosdoshmeri e pashmangshme.

Transporti i materialeve per ne vend-depozitimin eshte menduar te kryhet ne pjese te rralla per te shmangur krijimin e pirgjeve ne vendin e punes. Ngarkimi i materialit do te realizohet me eskavatore, transporti i tyre do te realizohet me kamion te tonazhi te mesme.



Depozitimi i materialeve kerkon seleksionim te thjeshte pasi mbetjet jane te se njejtës kategori "materiale ametare dherash, guresh, aluvionesh".

### 2.8.2 Mbyllja e Vend - depozitimit

Me mbyllje te vend-depozitimit do te arrihet ne dy rrethana:

1. Kur eshte arritur kapaciteti maksimal i depozitimit
2. Kur nuk gjenerohen materiale nga proceset e ndertimit te strukturave te Hec-ve Zheje dhe ne kete pike fillon marrja e materialit nga vend – depozitimi per te mbuluar terrenet e prekura ne masen e nevojshme.

Rasti i dyte eshte marre ne konsiderate te ndodhe keshtuqe mbyllja e vend- depozitimit do te kryhet kur eshte arritur hapja e nenobjekteve te nevojshme te Hec-ve Zheje dhe finalizimi i nenobjekteve funksionale te Hec-ve Zheje. Me pas fillon marrja e materialit nga vend – depozitimi per te mbuluar terrenet e prekura ne masen e nevojshme.

### 2.8.3 Sistemimi i materialeve ne Vend - depozitim

Shkarkimi i materialeve ne vend-depozitim do te kryhet sipas nje radhe te caktuar qe do te thote, materialet do te shkarkohen me shtresa.

Vend depozitimi eshte planifikuar temos ngjeshet, pasi nga vete procesi i mbushjes se tij; mbushje "me shtresa" perftohet ngjeshja natyrore dhe mekanike te lehte.

Sipas profileve anesore ne projektin per vend depozitim jane te planifikuara me shtresa, trashesia e te cilave eshte mesatarisht 1.51 m per te gjithë siperfaqen e planifikuar dhe pjerresia e skrapates varion. ( $30^{\circ} \div 35^{\circ}$ ).

### 2.8.4 Punimet e sistemimit te dheut

Te gjitha dherat qe do te gjenerohen nga germimet e ndryshme do te risistemohen per rehabilitimin e shesheve te germuara. Kjo mase dherash te germuar do te ndahet sipas tipeve ku ne menyre te veçante do trajtohet shtresa vegjetative e tokes (top soil), e cila sigurohet nga skarifikimet dhe qe do te perdoret si shtrese vegjetative ne venddepozitimet. Materiali do te sistemohet dhe do te ngjeshet duke harmonizuar relievin e shpatit dhe terrenit te destinuar per vend – depozitim. Faza perfundimtare ka te beje me mbulimin e materialit me shtrese dheu te afte per t'u mbjellur dhe vegjetuar.

Kjo siperfaqe do te mbillet me bimesi vendase ne menyre qe fenomeni erodues nga shirat dhe ujerat te parandalohet, po ashtu bimesia qe duhet te mbillet duhet te jete autoktone (bime vendase) per te mos thyer pejsazhin karakteristik te zones.

Masa e dherave te germuar do te ngjeshet dhe do te mbillet me shkurre dhe bimesi vendase ne menyre qe fenomeni erodues nga shirat dhe ujerat te parandalohet, po ashtu bimesia qe duhet te mbillet duhet te jete autoktone (bime vendase sic jane ato vendase te shkozës, dellinjes dhe

ahut) per te mos thyer pejsazhin karakteristik te zones. Keto ndikime te zhveshjes se relievit ne segmentet ku do realizohen punime ndodhin kryesisht gjate fazes se ndertimit, gjate fazes se ndertimit materialet e germuara do rikthehen perseri ne vendet e germuara duke minimizuar ndjeshem levizjen e materialeve. Kjo shihet ne tre aspekte:

- Se pari linjat e derivacioneve do te jene te mbuluara pothuajse ne te gjithë gjatesine e tyre dhe kjo mundeson ruajtjen e temperatures se ujit dhe nenobjekteve ne kushte te favorshme operimi.
- Se dyti restaurimi i pejsazhit pergjate traseve te ketyre nenobjekteve e kthen terrenin ne gjendjen e meparshme visuale ne nje periudhe shume te shkurter pasi gjeresia e trasese nuk eshte shume e gjere dhe per rrjedhoje gjelberimi dhe kafshet e kane te lehte te kryqezojne kete segment duke mos u kthyer ne nderprejje territoriale per to.
- Se treti ulet kostoja per transportimin e materialeve te germuara si pasoje e rikthimit te tyre ne po te njejtin vend duke mos paraqitur nevojë per levizje materiali te germuar jashte kantierit te ndertimit per kete kaskade.

### **2.8.5 Sistemimi i coperave te shkembinjve**

Subjekti ndertues duhet te sistemoje shkembinjte me permase te ndryshme ne shpate te ngjashme shkembore me qellim shtratimin strukturor te qendrueshem dhe mbi keto do te hidhet dhe. Kjo sasi dherash sigurohet nga tepricat e akumuluar nga materiali i germuar. Po ashtu me keto gure do te krijohen strukturat mbrojtese te veprave te marrjes dhe muret gabion çka ulin ne mase levizjen e madhe te materialeve nga vendi ku nxirren. Eshte perlogaritur qe i gjithë materiali qe prodhohet nga hapja e shesheve te objekteve do te riperdoret me qellim shtrimin e rrugeve me material te qendrueshem dhe se dyti do sherbeje si material inert baze per ndertimin e strukturave te armuara (betoneve).

### **2.8.6 Punimet e maturimit te shtratit te dheut.**

Para se te realizohet procesi i mbjelljes se terrenit te krijuar me bimesi vendase duhet qe dheu i hedhur te maturohet ne menyre qe te ofroje kushte te pershtatshme per mbjelljen e fidaneve. Fidanet duhet te mbillen ne prezence te specialistit mbikqyres te punimeve mjedisore ne menyre qe te respektohen distancat dhe varietetet e fidaneve qe do mbillen sic jane ato vendase te lisit, shkozës dhe dellinjës dhe pishave.

### **2.8.7 Mbjellja e fidaneve dhe bimesise vendase.**

